



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Data e nënshkrimit të Marrëveshjes me Participim: 18.04.2019

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel. 028 571 524

Duke u bazuar në nenin 17 pika a zhvillimi lokal ekonomik të Ligjit me Nr.03/L-040, si dhe Thirrjes për Aplikim të datës 06.02.2019, të shpallura nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, lidhë këtë:

MARRËVESHJE ME PARTICIPIM
Për projektin "Përkrahja e Bizneseve"

E përpiluar në mes të:

1. Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z.Xhafer Tahiri, në njërin anë në cilësinë e subvencionuesit dhe
2. Përfituesëve që kanë participuar për projektin "Përkrahja e bizneseve".

Neni 1

Qëllimi

Qëllim i lidhjes së kësaj marrëveshje me participim është përkrahja nga Komuna e Vushtrrisë në ngritjen e kapaciteteve në biznes.

Neni 2

Lënda e kësaj marrëveshje është participimi vullnetar i përfituesëve, lidhur me sigurimin apo grumbullimin e mjeteve financiare të përfituesëve për realizimin e projektit "Përkrahja e bizneseve", në bashkëfinancim me Komunën e Vushtrrisë si subvencionuese kryesore e këtij projekti.

Neni 3

Vlera e përgjithshme e mjeteve që duhet grumbulluar nga participimi i përfituesëve për realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje me participim është në vlerën e përgjithshme prej **17,646.50 €**.

Neni 4

4.1 Vlera e mjeteve që ka siguruar Komuna si subvencionuese kryesor për realizimin e projektit lëndor është shuma prej **100,000.00 €**, ndërkaq që projekti të realizohet duhet që përfituesit të participojnë vullnetarisht me mjetet në vlerën e cekur në nenin 3 të kësaj marrëveshje.

4.2 Vlera e tërësishme e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje është **117,646.50€**

Neni 5

Obligimet e Komunës

Komuna merr për obligim që me sigurimin e mjeteve nga përfituesit të bëjë realizimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje.

Neni 6

Në rast të mos grumbullimit të mjeteve Komuna gjegjësisht drejtoria për EBPZHR, do të bëjë stopimin e realizimit të projektit lëndor.

Neni 7

Obligimet e përfituesit

7.1 Përfituesit janë të obliguar të paguajnë shumën e participimit konform përqindjes së përcaktuar në bazë të vlerë së projektit, në xhironlogari të Komunës, në cilëndo prej bankave afariste.

7.2 Përfituesit janë të obliguar të zbatojnë këtë marrëveshje.

7.3 Përfitueseve nuk ju lejoheq që për tre(3)vite ta shesin, tjetërsojnë ose ta keqpërdorin subvencionin, në të kundërtën do të ndiqen penalisht.

Neni 8

Për ekzekutimin e kësaj marrëveshje kujdeset: Drejtoria e Prokurimit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 9

Kjo marrëveshje ka tretmanin e kontratës vullnetare në mes të palëve dhe e njëjta do të realizohet me përmbushjen e obligimeve nga ana e të dy palëve.

P A L Ë T E M A R R Ë V E S H J E S

Subvencionuesi:

Komuna e Vushtrrisë
z. Xhafer Tahiri
(Kryetari i Komunës)



Grupi i përfituesëve

1.Fakete Berisha Nr.personal:1005296168

2.Besim Hyseni Nr.personal: 1172783909

3.Arbenita Kajtazi Nr.personal: 1241437031

Fakete Berisha
BESIM HYSENI
Arbenita